



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 12489 Prot

Shkodër, më 19.07.2021

Lënda: Informacion për procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 në Bashkinë Shkodër

KESHILLIT BASHKIAK

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr 12451/1 datë 09.07.2021, administruar në Bashkinë Shkodër me protokoll hyres nr 12221 me datë 15.07.2021, ka dërguar Udhezimin plotësues nr. 20 date 09.07.2021 "*Për përgatitjen e buxhetit vendor*".

Në këtë udhëzim cilësohet:

- Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore do të mbështetet në legjislacionin aktual në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, si dhe në ligjin nr.68/2017 date 27.04.2018 "*Per financatë vetëqeverisjes vendore*".
- Transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2022, do të jetë në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2022-2024, sipas detajimit të parashikimit të dërguar në fazën e parë të PBA-së për vitet 2022-2024.
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e arsimit parashkollor për periudhën afatmesme 2022-2024, përfshin edhe rritjen e pagave të akorduar për njësitë e vetëqeverisjes vendore në vitin 2021.
- Formula, kriteret dhe koeficientet e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022 do jenë ato të vitit 2021.
- Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2022-2024, (se bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2021. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertes së pakushtëzuar/pakushtëzuar sektoriale do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transfemar dhe fatures financiare perkatëse.
- Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2022-2024, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024. Ai pasqyron parashikimet e treguesve

ekonomik dhe financiar të buxhetit të njësisë së veteqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësimete burimeve që njësia e vetëqeverisjes vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.

Në kushtet kur Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2022-2024, mbetet i njëjtë si në fazën e projektit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, Grupi i Menaxhimit Strategjik, në mbledhjen e datës 16 Korrik 2021, në mbeshtetje të nenit 37 të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” vendosi që tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2024 të jenë tavanet e miratuara nga Keshilli Bashkiak me vendimin nr. 19 date 25.03.2021 “ Per tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Shkoder” dhe sipas projektit të parë të PBA 2022-2024 të paraqitur për miratim në KB me shkresën 8085 date 25.05.2021 me objekt “Dërgim materiale të projektit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 për Bashkinë Shkoder”.

Duke ju uruar punë të mbarë,

Me respekt,



KRYETAR

Voltana Ademi

Zv. Kryetar

Ardit Gjyllybi

Zv. Kryetar

Fetbardhë Shkedi

Zv. Kryetar

Tomir Sedrej

Drejtorja e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

Genel Haro

Drejtorja e Financës

Blerta Mydler

Drejtoria e të Ardhurave

Gregor Kumbi

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Teuzna Hshe

Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

Samon Zaja

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Andete Reraj

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP

Alban Selja

Drejtoria e Turizmit

Genion Ramo

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe

Solonez Ujka

Drejtoria Juridike

Burhan Gjo

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës

Alfred Lule

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Felix Vile

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave

Jida Shllaku

Drejtoria e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit të Investimeve

Alpa Kodra

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Rioban Sokoli

Policia Bashkiake

GENT ARMANI